

UDHËZIM
Nr. 14, datë 28.7.2021

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 30, DATË 12.9.2018,
“PËR NUMRIN E NXËNËSVE PËR KLASË DHE NORMAT E PUNËS MËSIMORE
NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “d”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 30, datë 12.9.2018, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:
 - a) germat “a” dhe “b”, të pikës 2, të seksionit A, të kreut II, ndryshohen si vijon:

“a) dy klasa paralele, kur numri i nxënësve është 30–59;
b) tri klasa paralele, kur numri i nxënësve është 60–99;”
 - b) Pika 4, e seksionit A, e kreut II, ndryshohet si vijon:

“4. Numri i punonjësve mësimorë në arsimin fillor të llogaritet një mësues për çdo klasë. Lëndët e: TIK, Gjuhë e huaj dhe Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti (1 orë), do të zhvillohen nga punonjësit mësimorë të arsimit të mesëm të ulët, sipas profilit përkatës.”
 - c) Pas pikës 4, të seksionit A, të kreut II, shtohet pika 5 me përmbajtje si vijon:

“5. Në shkollat speciale klasat formohen me jo më pak se 6 nxënës.”
 - d) Pas germës “d”, të pikës 2, të seksionit B, të kreut II, shtohet germa “e”, me përmbajtje si vijon:

“e) në klasat kolektive, kur ka më shumë se 10 nxënës, mësimi zhvillohet i ndarë vetëm për lëndët Gjuhë shqipe, Gjuhë e huaj dhe Matematikë.”
 - e) Pikat 2 dhe 3, të seksionit C, të kreut II, ndryshohen si vijon:
 2. *Kur numri i nxënësve është 200–480, emërohet një nëndrejtor shkollë.*
 3. *Kur numri i nxënësve është 481–900, emërohen dy nëndrejtorë shkollë.*
 - f) Pikat 6, 7, 8, 9 dhe 10, të seksionit D, të kreut II, ndryshohen, si vijon:

“6. Drejtori i shkollës me 81–300 nxënës: 6 orë në javë
7. Drejtori i shkollës me 301–600 nxënës: 4 orë në javë
8. Drejtori i shkollës me 601–900 nxënës: 2 orë në javë
9. Drejtori i shkollës mbi 900 nxënës: 0-2 orë në javë
10. Nëndrejtori i shkollës: 6 orë në javë”
 - g) Pika 1 e seksionit A, të kreut III, ndryshohet si vijon:

“1. Klasat në zonat urbane të formohen me jo më pak se 25 nxënës dhe në zonat rurale me jo më pak se 10 nxënës.”
 - h) Pikat 1 dhe 2, të seksionit B, të kreut III, ndryshohen si vijon:

“1. Kur numri i nxënësve është 200–480, emërohet një nëndrejtor shkollë.
2. Kur numri i nxënësve është 481–900, emërohen dy nëndrejtorë shkollë.”
 - i) Pikat 4, 5, 6, 7 dhe 8, të seksionit C, të kreut III, ndryshohen si vijon:

“4. Drejtori i shkollës me 81–300 nxënës: 6 orë në javë
5. Drejtori i shkollës me 301–600 nxënës: 4 orë në javë
6. Drejtori i shkollës me 601–900 nxënës: 2 orë në javë
7. Drejtori i shkollës mbi 900 nxënës: 0-2 orë në javë

8. Nëndrejtori i shkollës: *6 orë në javë*”.

j) Pika 10, e kreut V, ndryshohet si vijon:

“10. Mësuesi që drejton bibliotekën e shkollës i llogariten:

a) 2 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka deri në 300 nxënës;

b) 3 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka mbi 301–600 nxënës;

c) 4 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka mbi 600 nxënës.”.

k) Pika 22, e kreut V, ndryshohet si vijon:

“22. Mësuesi mentor, për mentorimin e një praktikanti, u ulet norma me 2 në javë. Një mësues mentoron 1–2 praktikantë.”.

l) Pas pikës 24, shtohen pikat 25 dhe 26, me përmbajtje si vijon:

“25. Si rregull mësuesit të cilëve u është ulur norma për kryerjen e veprimtarive të ndryshme të përcaktuara në këtë udhëzim nuk mund të ngarkohen me orë shtesë të pagueshme përveç rasteve kur shkolla në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore nuk mund t’i mbulojë ato me mësues të tjerë.

26. Në shkollën koreografike mësuesit e specialitetit balet e kanë ngarkesën 20 orë në javë.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi